

L I G J

8690

datë 16.11.2000

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN "PËR MBROJTJEN E MJEDISIT DETAR DHE TË ZONËS BREGDETARE TË DETIT MESDHE, SI DHE TË 6 PROTOKOLLEVE SHOQËRUESE"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I . REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Konventën "Për mbrojtjen e mjedisit detar dhe të zonës bregdetare të Detit Mesdhe, si dhe të 6 protokolleve shoqëruese"; 1. Protokollin për parandalimin dhe shmangien e ndotjes së Detit Mesdhe nga mbeturinat e anijeve dhe të aeroplanëve ose nga djegia e tyre në det. 2. Protokollin për bashkëpunimin për të luftuar ndotjen e Detit Mesdhe nga nafta dhe nga substancat e tjera të dëmshme, në raste emergjente. 3. Protokollin për mbrojtjen e Detit Mesdhe nga ndotjet e veprimtarive të vendosura në tokë. 4. Protokollin për zonat specifike të mbrojtura dhe për diversitetin biologjik. 5. Protokollin për mbrojtjen e Detit Mesdhe nga ndotja që shkaktohet nga eksplorimi dhe shfrytëzimi i shelfit kontinental, i shtratit të detit dhe i nëntokës së tij. 6. Protokollin për parandalimin e ndotjes së Detit Mesdhe nga lëvizja ndërkufitare e mbeturinave të rrezikshme dhe nga depozitimi i tyre.

Neni 2

Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Mjedisit të derdhë kontributin financiar vjetor të Republikës së Shqipërisë, detyrim ky që i lind vendit tonë si palë në këtë konventë dhe në protokollin e saj.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Skënder Gjinushi

Shpallur me dekretin nr.2815, date 5.12.2000 te Presidentit te Republikes se Shqiperise
Rexhep Meidani